



- Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt
- Denonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet ▾
- Përmbledhja MujorePër sinjaliziminTë Guximshëm pa Armë

Breaking News:

Tiranë/Kapen 4 shtetas të shpallur në kërkim kombëtar



29/05/2025

Maliq/Finalizohet Operacioni I Koduar “Kolaneci”, Sekuestrohen 2 Armë Zjarri

Maliq/Kontrolle intensive bazuar në inteligjencën policore, për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërive.

Finalizohet operacioni i koduar “Kolaneci”, për goditjen e një rasti të armëmbajtjes pa leje.

Vihet në pranga një shtetas që posedonte 2 armë zjarri (kallashnikov dhe pushkë).

Sekuestrohen 2 armët e zjarrit.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Maliq, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruara në rrugë operative se një shtetas mbante armë zjarri në banesë, kanë organizuar operacionin e koduar “Kolaneci”.

Gjatë kontrollit në ambientet afër banesës së shtetasit J. D., shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri automatik dhe 1 armë zjarri pushkë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve procedurale, u arrestua në flagrancë shtetasi J. D., 64 vjeç, banues në fshatin Kolanec, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe e municionit”.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.


#angazhimpërkushtimsakrificë
#tëvendosurkundërkrimit✔
#nëçdoskajtëvendit
#nëshërbimtëqytetarëve
#denonconë112✔

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Policia e Shtetit/Ekstradohen në Itali, 3 shtetas të implikuar në veprimtari në fushën e narkotikëve

Raporti i ngjarjeve, 29 maj 2025 ▶